



MEETING MINUTES

# **ZBARDHJE E MINUTAVE NGA TAKIMI I ANËTARËVE TË BORDIT EITI**

8 Qershor 2020

11:00 AM

ON SKYPE

LIST PREZENCA

---

Z. GENCI TËRPO, **DREJTUES I SEKRETARIATIT KOMBËTAR EITI**

Z. ILIR BEJTJA, **KRYETAR I MSG-së, ZV/MINISTËR I MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGISË**

Z. ROBERT BESHELLO, **AGJENSIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE**

ZNJ. ANILA HAJNAJ, **SHOQËRIA CIVILE**

Z.SAMI NEZA, **SHOQËRIA CIVILE**

ZNJ. OLA MITRE **SHOQËRIA CIVILE**

Z. LORENC GORDANI, **SHOQËRIA CIVILE**

Z. DRITAN DERVISHAJ, **ANTEA CEMENT**

PJESËMARRËS TË TJERË

---

Z. LLUKA GJERGO, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

ZNJ. EMILIANA KOLA, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

FOTO NGA TAKIMI I MSG-së

---



**Z. GENCI TËRPO** Faleminderit që bëtë të mundur të merrnit pjesë në mbledhjen e radhës të MSG-së e cila është shtyrë për një periudhë për shkak të situatës së pandemisë. Me hapjen deri diku të vendit dhe besojmë që deri tani duket sikur krejtësisht është normale, çdo lloj gjëje, nuk është më siç ka qënë, mendoj që dhe aktiviteti ynë do të jetë edhe më i shtuar, duke shpresuar që dhe takimet të mos i bëjmë më përmes platformave dixhitale por mund t'i bëjmë edhe në ambiente më të favorshme.

Atëhere më lejoni pikë së pari t'ju tregoj punën që ne kemi bërë gjatë periudhës së pandemisë e cila në fakt ka qënë e vështirë për të gjithë. Siç jeni në dijeni, ne jemi duke u marrë dhe vazhdojmë të merremi me realizimin e raportit EITI 2017-2018. Duke pasur parasysh kontratën e lidhur midis EITI-it dhe administratorit të pavarur si dhe që ky raport duhej të ishte realizuar brenda datës 30 prill të këtij viti; fatkeqësisht periudha e pandemisë bëri të mundur që një pjesë e konsiderueshme e kompanive duke përfshirë dhe disa institucione shtetërore të mos raportnin në kohë dhe kjo deri diku ishte e pritshme duke qënë se zakonisht punohej nga shtëpia dhe njerëzit nuk ishin shumë të pranishëm pranë zyrave të tyre. Nga ana tjetër mendoj se administrator i pavarur për të përgatitur raportin EITI...(shkëputet lidhja)

Ju kërkoj ndjesë për shkëputjen ,... më falni pak....

Atëhere siç po ju thoja; qoftë nga ana jonë, qoftë nga ana e administratorit të pavarur është punuar por kuptohet është punuar në një marzh të kufizuar, nisur nga fakti që pjesa më e madhe e institucioneve dhe përgjithësisht pjesa dërrmuese e kompanive nuk kanë patur të mundur të punonin dhe të raportnin për shkak të lockdoën-it. Megjithatë le të themi që ne jemi munduar maksimalisht t'i kontaktojmë; të telefonojmë apo të dërgojmë email-e dhe deri më sot kemi arritur në një situatë raportimi për gati gjysmën e kompanive.

Gjithashtu duke patur parasysh që Grandi i Bankës Botërore ishte i limituar deri në fund të muajit prill, kemi bërë të mundur që ky Grand të zgjatet deri në 31 dhjetor 2020, në mënyrë që ne të kemi mundësinë që të zhvillojmë të gjitha

aktivitetet që nuk janë bërë nga EITI për periudhën e shkuar deri në këtë periudhë. Kemi punuar përsa i përket rishikimit të Termave të Referencës të aktiviteteve që ne kemi parashikuar... Kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me Bankën Botërore për miratimin e tyre dhe gjithashtu kemi realizuar zgjatjen e dy kontratave; njërin me ekspertin e prokurimeve dhe tjetrën me ekspertin financiarë që është....

Megjithatë, aktualisht situata e raportimit nga kompanitë është që lidhur me Raportin e vitit 2017, kanë deklaruar 72 subjekte. Janë pa deklaruar akoma 55 subjekte, nga të cilat 22 prej tyre kanë deklaruar që do t'a vijojnë raportimin pas pandemisë. Shpresojmë që nisur nga situata e hapjes, do të jetë e mundur që këto subjekte që kanë shprehur konsentin për të deklaruar t'a realizojnë 7këtë gjë sa më shpejt. Kemi pasur 7 subjekte që nuk kanë pranuar të deklarojnë, gjithashtu nga këto 55 për 8 subjekte po verifikohet statusi i tyre.

Përsa i përket subjekteve hidrokarbure për Raportin 2017-2018, kemi patur një problem me AlbPetrol-in që besoj se e kemi zgjidhur, me vendosjen e administratorit të ri të kësaj kompanie, kemi kontaktuar me të dhe shpresojmë të kemi një raportim sa më të shpejtë. Gjithashtu për këtë periudhë 2-vjeçare kanë raportuar 6 subjekte nga subjektet hidrokarbure dhe 2 subjekte kanë deklaruar se do të raportojnë pas pandemisë. Një subjekt ka shitur aksionet për të cilin ka deklaruar blerësi dhe një subjekt është larguar për mosplotësimin e detyrimeve.

Lidhur me subjektet hidroenergjerike për Raportin 2017-2018 për të dy vitet, 6 subjekte kanë raportuar dhe 5 prej tyre do të deklarojnë pas pandemisë. Ndërkohë për 4 subjekte, kontaktet nga QKB-ja nuk kanë rezultuar të sakta dhe ne jemi përpjekur që të gjejmë kontaktet e reja në mënyrë që të bëhet i mundur raportimi i tyre.

Ndërsa lidhur me institucionet shtetërore, le të themi që pjesa më e madhe e institucioneve kanë raportuar por kuptohet ka nevojë për disa saktësime. Në ditët në vijim ne së bashku me administratorin e paravarur do të zhvillojmë kontakte të drejtpërdrejta me të gjitha institucionet shtetërore që kanë nevojë

përsa i përket raportimit. Pretendojmë që këtë gjë ta bëjmë sa më shpejt brenda kësaj jave.

**Z. ILIR BEJTJA:** Përshendetje.....

**Z. GENCI TËRPO** Atëhere me qenë se dhe Z. Bejtja u bashkua...

Z.Bejtja, ne filluam pak më herët sesa të ishte bërë e mundur lidhja me ju dhe unë përfitova nga rasti që të bëja një raportim; atë çka ua kam dërgua me email, qoftë dhe për anëtarët e tjerë të MSG-së. Kështu që ne jemi brenda... le të themi një informacioni të plotë që ju e keni marrë me email dhe anëtarët e tjerë të MSG-së po e dëgjojnë sot.

Siç ju thashë, situata është që pjesa më e madhe e kompanive kanë raportuar por tashmë kërkohet që dhe kompanitë e tjera të raportojnë, gjithashtu dhe subjektet ose më saktë institucionet shtetërore të bëjnë të mundur rishikimin edhe një herë raportimit dhe përgjigjen e pyetjeve që kompania Deloitte u ka dërguar për të bërë sqarimet e nevojshme.

Natyrisht që lidhur me institucionet që operojnë në fushën e industrisë nxjerrëse, pjesa më e madhe e tyre kanë qenë korrekte. Ka nevojë për disa sqarime përshembull në rastin konkret nga Drejtoria Hidroenergjetike në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë ka nevojë për disa sqarime të vogla të cilat ata shumë shpejt besoj ata do t'i japin.

Ndërsa përsa i përket subjekteve deklarues, ne kemi përpiluar një listë të plotë të të gjithë subjekteve dhe ia kemi dërguar Drejtorisë Minerare pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Hasalami duke shpresuar që edhe ai përmes burimeve të tij të bëjë të mundur që t'i shtyjë këto kompani që të raportojnë sa më shpejt që të jetë e mundur për të mos na vonuar më tepër.

Ashtu sikurse ju thashë ky raport duhej të ishte realizuar në 30 prill 2020. Situata e pandemisë bëri të mundur që të mos realizohej. Nga bisedat dhe takimet që kemi bërë me kompaninë Deloitte, ata e kanë çmuar që është pak e vështirë për të përcaktuar një afat prej tyre lidhur me kohën e mundur se kur mund të

realizohen të dyja raportet. Nisur nga kjo situatë, ne kemi konceptuar zgjatjen ose më saktë amendimin e kontratës me kompaninë Deloitte për një afat tjetër, afat i cili duhet të jetë i tillë që të bëjë të mundur realizimin e këtij raporti.

Gjithashtu nisur nga situata që kemi pasur më përpara përpara i përket, mungesës së pagesave që I janë bërë kompanisë Deloitte, le të themi që tashmë kjo situatë është zgjidhur, EITI nuk është më debitor ndaj asnjë lloj institucioni, qoftë privat, qoftë shtetëror. Kemi bërë të mundur realizimin e pagesave të prapambetura për disa çështje lidhur me kompaninë Deloitte apo dhe me subjektet e tjera. Tashmë ne jemi, le të themi në vitin zero, ku çdo gjë fillon nga fillimi, nuk kemi më asnjë lloj detyrimi ndaj këtyre kompanive, thjesht e kemi ndoshta pak më të lehtë për të ushtruar një farë presioni pozitiv në mënyrë që kompanitë të bëjnë të mundur të punojnë më mirë duke qenë se ne po tregohemi korrektë përpara i përket detyrimeve që kemi kundrejt tyre.

Unë do të doja dhe mendimin tuaj përpara i përket afatit që ju vlerësoni duke pasur parasysh një projeksion të caktuar, ne nuk e dimë se çfarë do të ndodhë nëse do të ketë ndoshta një valë të dytë të pandemisë apo nëse do të ketë sërish një lockdoën dhe kjo mund ta vështirësojë deri diku dhe çështjen e raportimit por shpresojmë që t'i vendosim një afat kompanisë Deloitte për të bërë të mundur raportimin në mënyrë që të kemi një material sa më shpejtë. Unë për mendim tim do të isha që ky afat të ishte diku gjatë vjeshtës, duke pasur parasysh që periudha korrik-gusht mund të jetë një periudhë pushimesh dhe një pjesë e institucioneve apo subjekteve ndoshta sërish do të hasin vështirësi në raportim. Megjithatë kjo ngelet për t'u diskutuar dhe nga ju, unë gjithnjë do të isha me idenë që kjo gjr të realizohet sa më shpejt, t'i jepet më shumë kohë qoftë dhe administratorit të pavarur për të realizuar raportin. Nuk e di në qoftë se ka ndonjë mendim nga anëtarët e MSG-së përpara i përket kohës që ju mendoni se kur mund të shtyhet ky raport dhe nga ana tjetër një nga pikat e rëndësishme të kësaj mbledhjeje është që ne do t'i kërkojmë sërish..... të paraqitet raporti EITI 2017-2018, nisur nga kjo situatë por paralelisht edhe shtyrjen e afatit përpara i përket procesit të validimit i cili le të themi që ka patur si datë

finale datën 30 qershor 2020. Por nisur nga kjo situatë ne ose më saktë administrator i pavarur nuk do të jetë në gjendje që t'a realizojë raportin Brenda kësaj periudhe. Nga bisedat që kemi bërë koha më e mirë e tyre, sikur çdo gjëtë shkonte në rregull do të ishte data 13 ose 15 korrik por nuk mund të rrezikojmë për të lënë një afat kaq të shkurtër dhe të kthehemi për t'a amenduar sërish kontratën. Unë mendoj që të kërkonim një zgjatje të afatit të paktën deri në vjeshtë, qoftë përsa i përket realizimit të raportit, qoftë dhe validimit.

**Z.Bejtja:** Po, po cilat janë risqet?

**Z.Genci Tërpo:** Nga bisedat që kemi bërë me EITI-in në Oslo, ua kemi bërë....., madje ata vetë na e kanë propozuar si mundësi që të kërkonim një shtyrje të afatit, gjë të cilën unë në projektionin e EITI-it vendoso që t'jua parashtroja në mes të muajit qershor, brenda kohës dhe ata deri diku ishin dakort të paktën parimisht sa kemi diskutuar që mund të shtyhet afati i dorëzimit të raportit. Natyrisht që risku ka të bëjë dhe me me pjesën e validimit sepse presupozohej që ky raport duhej të prodhohej dhe të shpërndahej brenda muajit prill, ndërkohë që procesi i validimit ka patur si moment final datën 30 qershor, që do të thotë që çfarë ishte bërë deri 30 qershorit duhej të validohej më pas pjesa mbrapa i përket një validimi tjetër. Nisur nga kjo situatë që ka qenë e paparashikueshme pra e thënë ndryshe në qoftë se nuk do të ishte situata e pandemisë kjo gjë do të ishte realizuar. Por sot që flasim ky është një element shtesë që na ka çuar në këtë lloj shtate dhe të paktën EITI ka qenë edhe mirëkuptues përsa i përket kërkesës sonë të mundshme që mund të bëjmë lidhur me shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit.

**Z.Bejtja:** Se di si e mendojnë kolegët e tjerë por nëse ne nuk kemi problem me penalizimet deri në vjeshtë që thoni ju, ok, por am përshtypjen që duke me pyetur atje njëherë.

**Znj Anila Hajnaj:** Po, a mund të propozoj dhe unë diçka?... Jam dakort me atë që thoni ju, që të pyesim atje...po ideja ime ishte kjo që ne t'i kërkojmë Sekretariatit shtyrjen e raportit por duhet të jemi shumë të sigurtë. Mesa di unë ti



Genci, edhe unë kemi folur personalisht me ata të Sekretariatit dhe ideja ka qenë të shtyhet validimi. Atëhere nëse është e mundur me kërkesën që do t'i dërgojmë Sekretariatit, të bëjmë edhe një pyetje se ku mendojnë ata të kërkojmë shtyrjen e validimit dhe kur mendojnë ata që mund të realizohet dhe në përputhje me atë datë ne mund t'i kërkojmë pastaj administratorit shtyrjen e përfundimit të afatit të raportimit. Kështu që le t'i përshtasim të dyja datat që ne të jemi brenda afateve në raport me datën e ardhshme të validimit.

**Z. Ilir Bejtja:** Dakort...Si e mendojnë të tjerët?

(Të gjithë bien dakort)

**Z.Genci Tërpo:** Atëhere ideja është që brenda kësaj jave ne të realizojmë një videocall me EITI-in Ndërkombëtar, le të themi që në një farë forme është gjysëm e përgatitur pasi gjatë kesaj kohe kemi biseduar disa herë me EITI-in në Oslo dhe ata vetë e kanë shtruar si ide shtyrjen e afatit dhe deri diku shtyrja e afatit të raportit kjo mendoj se është e ezauruar, është e zgjidhur. Ndërkohë po mundohemi të ezaurojmë dhe pikën tjetër që i përket çështjes së validimit. Nga kontaktet që unë kam patur me ta, presupozohet që procesi i validimit prej tyre të mund të fillonte si periudhë më të herëshme, tetorin e këtij viti, pra gjatë vjeshtës. Por ishte e paparashikuar sërish pasi kjo varej shumë nga masat që do të merrte qeveria norvegjeze përse i përket procesit të pandemisë që ndoshta mund të kthehej ose jo dhe ishte dhe për ta e paparashikuar. Megjithatë do ta diskutojmë sërish dhe përse i përket çështjes së raportit EITI, qoftë dhe çështjes së validimit. Ne mund të kemi sërish një takim përmes kësaj platform për t'a ridiskutuar edhe një herë këtë çështje, mendoj maksimumi fillimi i javës që vjen. Ose nëse ju e çmoni që mund të realizohet dhe brenda kësaj jave, për ne nuk është problem...

**Z. Ilir Bejtja:** Jo nuk prish punë, javës që vjen, po mos ndoshta paralel duhet të komunikojmë dhe me Bankën Botëërore për çështjen e mbështetjes financiare? Kjo duhet koordinuar dhe me bankën pasi ka dhe ajo deadline-et e saj duke

pasur parasysh dhe burokracinë në Ministrinë e Financave shpesh herë për miratimin e marrëveshjes së grand-id. Nëse kemi problem..

**Z.Genci Tërpo:** Këtë gjë e kemi zgjidhur, kemi komunikuar me bankën, për ta nuk përbën asnjë problem por çdo gjë do të kryhet brenda datës 31 dhjetor 2020, pra na jep pak kohë në mënyrë që të kemi mundësi që t'i bëjmë të gjitha. Pra nga Banka Botërore nuk përbën asnjë problem , procesi i disbursimit është bërë dhe për ne çdo gjë është më e thjeshtë përsa I përket kapaciteteve financiare për të realizuar këto lloj aktivitetesh.

**Z. Ilir Bejtja:** Ok, në rregull

**Z.Genci Tërpo:** Dhe dicka tjetër që doja të diskutoja....., duke pasur parasysh që administratori i pavarur përgjithësisht e ka patur të pamundur të mund të shkojë dhe t'i kontaktojë vetë kompanitë, çmujmë që është e nevojshme nga ana jonë që të realizojmë sa më shpejt takime me të gjitha kompanitë apo institucionet që nuk është e mundur të merret feedback apo raportim. Siç e dini EITI deri diku I ka burimet e kufizuara përsa i përket mundësisë së lëvizjes, pra ne realisht nuk kemi automjete që të lëvizim qoftë të gjithë bashkë apo të ndarë për t'a bërë sa më eficient procesin e punës. Nisur nga situatë në fjalë kemi menduar që mund të përdorim automjetet tona në të mirë të punës. Edhe për këtë çështje unë do të doja miratimin e MSG-së përsa I përket mundësisë që kemi për të lëvizur sepse është pak e vështirë, të gjithë punonjësit që unë kam biseduar e kanë nga një automjet personal, kuptohet kjo sipas rregullat që përcakton dhe ligji i lëvizjes midis qyteteve.

**Z. Ilir Bejtja:** Do të duhet t'u japësh naftë atyre. Ne më përpara kemi pasur një praktikë e cila na rezultoi e suksesshme; t'u dërgosh një kërkesë me shkrim bizneseve të mëdha të industrisë nxjerrëse, nëse mund të krijojnë një fond solidariteti për këtë punë, që të mbulohen një pjesë e mirë e shpenzimeve që ndoshta janë të rrituara për shkak të pandemisë; çështja e lëvizjes apo ndonjë element tjetër që mund të duhet dhe ky fondi të mbikqyret nga MSG-ja në mënyrë transparente. Pasi çështja është se ju nuk mund të dilni dot nga

programi i miratuar, qoftë me paratë e raportimit, qoftë me paratë e buxhetit dhe kjo është problem.

**Z.Genci Tërpo:** Atëhere ne përsa i përket fondeve që kemi nga buxheti i shtetit, e kemi parashikuar këtë lloj aktiviteti.

**Z. Ilir Bejtja:** Nëse e keni të parashikuar, nuk keni pse të kërkonit aprovimin tonë. Ne e kemi miratuar buxhetin dhe nëse nuk ka dalje nga parashikimi është në rregull

**Z.Genci Tërpo:** Jo nuk jemi në këtë lloj situatë, unë kam konsultuar legjislacionin përkatës dhe kjo çështje është zgjidhur duke iu referuar dispozitave të kodit të punës ku vetë ligji e parashikon në rastet kur nuk ka mjete në një institucion, punonjësit mund të përfundojnë proceset e punës me automjetet e tyre dhe kjo është e vetjma zgjidhje për t'u drejtuar në ato kompani të cilat nuk kanë raportuar.

**Z. Ilir Bejtja:**Jam dakort nëse nuk ka asnjë problem ligjor

**Znj Anila Hajnaj:** Edhe unë jam dakort por duhet të kemi parasysh që të mos dëmtojmë dhe njerëit në këtë rast pasi automjeti konsumohet. Kështu që brenda një tarife të caktuar duhet të futet dhe konsumimi i automjetit që përdoret se ndoshta do të kenë nevojë për riparim. Në përgjithësi kështu bëhet ose është ajo që thotë Z. Ilir që duhet kërkuar një fond i caktuar nga këto kompanitë e naftës që nuk besoj të jetë shumë i madh dhe të ndahet në mënyrë proporcionale sipas kilometrave që bën mjete, ku të përfshihet dhe karburanti dhe konsumimi në mënyrë që të jemi faire me të gjithë.

**Z. Genci Tërpo:** Legjislacioni Anila, e lejon dhe atë pjesë që ju parashtroni por thjesht ne jemi munduar të bëhet puna.....

**Z. Ilir Bejtja:** Lereni në fondin e solidaritetit atë, krijojmë këtë fondin e solidaritetit pasi do ta kemi të drejtën t'a administrojmë me vendim të MSG-së pasi nuk është fond publik dhe nëse ai fond krijohet të mos jetë vetëm për Sekretariatit por edhe për ndonjë takim a dicka tjetër të MSG-së, shpenzimet të jenë të

përballuara. Duhet t'ju bëjmë një kërkesë kompanive të industrisë nxjerrëse për mbështetje pa ju vendosur limite lidhur me financimet, do angazhohem dhe unë kundrejt kësaj. Mund ta përdorim përtej programit të publikimeve që kemi nëpërmjet fondeve të Bankës Botërore, mund të kemi dicka më tepër se aq sidomos për shoqërinë civile pasi të tjerët janë të mbështetur dhe nuk besoj se ata që vijnë nga institucionet e tjera kanë nevojë për mbështetje nga EITI por pjesa e shoqërisë civile, sindikatë patjetër që kanë nevojë.

**Z. Genci Tërpo:** Ok, ide shumë e mirë

Atëhere përse i përket raportimit unë kaq kasha nga puna që kemi bërë, ndoshta secili prej jush mund të ketë dhe aktivitete të tjera. Na qoftë se keni ndonjë pyetje apo paqartësi lidhur me atë çka ne kemi bërë deri më sot. Nën gjykimin tim, unë kam vënë re që kemi punuar me të njëjtin ritëm si të kishim qenë në zyrë. Kjo pasi edhe puna jonë është e tillë që duke qenë se ne nuk ofrojmë shërbime, secili prej nesh e ka patur më të lehtë të punojë nga banesa dhe natyrisht që kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm qoftë me institucionet, qoftë me administratorin e pavarur apo dhe me anëtarët e MSG-së për t'i sqaruar përse i përket aktivitetit tonë deri më sot.

**Z. Ilir Bejtja:** Për t'a përmbledhur; dy kërkesat që tha Anila sa më parë; që të kemi mundësi që të garantojmë afatet dhe pjesa e krijimit të fondit të solidaritetit për të mbështetur aktivitete që nuk mund të planifikohen me fonde buxhetore apo financimin e Bankës Botërore. Duhet të kesh një format kërkesë besoj, nëse nuk e gjeni mund ta hartojmë e ta nisim.

**Znj Anila Hajnaj:** Edhe dicka tjetër Z. Ilir meqë jeni prezent, unë jam shumë e gatshme të bashkëpunoj në këtë gjë sepse kam kontakte të drejtpërdrejta me kryetarë të bashkive dhe personat që janë drejtorë të tatimeve, të cilët më kërkojnë informacion duke qenë se unë po raportoj projektet e zviceranit për shoqërinë civile dhe për raportin e monitorimit të rentës. Keshtu që kam kontakte të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme. Ne mund t'ju kërkojmë ndihmë edhe bashkive që të kontaktojnë kompanitë që janë atje. Kështu që unë jam e

gatshme ta bëj këtë gjë për 10 rrethe. Ne duhet të koordinojmë mirë dhe besoj se do të arrijmë shumë suksese por duhet të jemi shumë në kontakt me njëri-tjetrin dhe të koordinojmë veprimet. Të përfshijmë dhe pushtetin lokal pasi ata kanë autoritetin për të kontrolluar dhe kanë lidhje të drejtpërdrejta në terren.

**Z. Ilir Bejtja:** Jam shumë dakort, por ata janë dhe të interesuara...

**Z. Genci Tërpo:** Edhe dicka të fundit; ideja është që për pjesën e kompanive që nuk kanë raportuar ne iua kemi drejtuar Drejtorisë Minerare

**Z. Ilir Bejtja:** Po, sipas shkresës suaj jemi duke u marrë, është duke u marrë Z. Mehmet Hasalami direkt

**Z. Genci Tërpo:** Dakort, kjo është shumë e rëndësishme për ne dhe besoj që tashmë do të vihet dhe më në lëvizje procesi.

Atëhere, po e lemë sipas porosite tuaja, ne do të jemi nesër me EITI-in në Oslo për të marrë konfirmimin e tyre përse i përket të dyja proceseve dhe për ta pershpejtuar procesin do të ishtë më e mira të bënim një video-konferencë sërish në një kohë sa më të shpejtë ndoshta dhe brenda kësaj jave. Nuk besoj se ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar.

**Z. DRITAN DERVISHAJ:** Jo, thjesht tek pika e dytë nuk lamë datë, presim çfarë do të thonë nga EITI qëndror?

**Z. Genci Tërpo:** Mendoj se që nesër, maksimumi pasnesër ju do të merrni ditën e ardhshme se kur do të realizohet sërish ky video-takim por unë besoj se do ta realizojmë Brenda kësaj jave.

**Z. ROBERT BESHELLO:** Më falni, kisha një pyetje; ju thoni që janë disa, rreth 9 kompani në mos gaboj që nuk duan të raportojnë dhe pyetja është :

Këta kanë konfirmuar më shkrim që nuk duan të raportojnë dhe janë nga industria minerare apo hidrokarbure?

**Z. Lluka Gjergo:** Janë minerare, janë 7 kompani dhe realisht nuk pranojnë të raportojnë si dhe 7 kompani që pretendojnë se nuk kanë status aktiv. Nesër do

të jemi bashkë dhe kompania Deloitte, ju dhe unë dhe do të përcaktojmë një format për këto lloj kompanish pasi kemi dhe hapësira ligjore ku mund të themi që nuk është dëshirë por detyrim.

**Z. Genci Tërpo:** Ok, nëse nuk kemi gjë tjetër, mund ta mbyllim?

Mirupafshim!

**Mbyllet mbledhja 34:07'**